



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Nr. Prot. 01-544/114  
Br Prot. 01-544/114  
Prot No  
Data  
Datum 11-02-2014  
Nr. pages 03  
PRISHTINE

DATË/A:	11/02/2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Abdulsatar IBRAHIMI Drejtore i Departamentit të Prokurimit në KOSTT sh.a
CC:	z. Naim BEJTULLAHU Kryeshef Ekzekutiv në KOSTT sh.a
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin: “Shërbimet e Sigurimit Fizik të Objekteve të KOSTT-it”



Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin “Shërbimet e Sigurimit Fizik të Objekteve të KOSTT-it” me nr. prokurimi: KOSTT-13-35-211, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues, që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin “Shërbimet e Sigurimit Fizik të Objekteve të KOSTT-it” me nr. prokurimi: KOSTT-13-35-211” në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

## Arsy e tim

KOSTT, si Autoritet Kontraktues ka përgatitur “Njoftimin për Kontratë” me titull: “Shërbimet e Sigurimit Fizik të Objekteve të KOSTT sh.a” me nr. të prokurimit: KOSTT 13-35-211. Ky aktivitet prokurimi më datë 09//12/2013 është publikuar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP). Agjencia Kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë aktivitet Prokurimi si rast për trajtim dhe gjatë ekzaminimit të aktivitetit të prokurimit nga “Dosja e Tenderit”, Agjencia Kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në përputhje të plotë me Procedurat e Prokurimit në Kosovë.

Në Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), pika 7.1, Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, kërkohet: **Të gjithë anëtarët e grupit duhet të sigurojnë dëshmitë e kërkuara dokumentare.** Kërkesat që kanë të bëjnë me Gjendjen Ekonomike dhe Financiare, si dhe Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale duhet të plotësohen nga Grupi i Operatorëve në tërësi, e jo nga secili Operator Ekonomik veç e veç, siç është kërkuar në “Dosja e Tenderit”

Në Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), pika 9.1, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nën-pika a) kërkohet: **Operatori duhet të ketë 3 menaxher të Licencuar për Shërbime të Sigurimit Themelor pranë MPB.** Bazuar në ligjin për Shërbimet Private të Sigurisë, Kompania duhet të ketë Menaxherin e Sigurimit, pra kërkohet një menaxher i sigurimit për tu licencuar dhe për të ushtruar funksionin si Kompani e Sigurimit. Autoriteti Kontraktues ka kërkuar 3 menaxher, me këtë rast eliminon Kompanitë që janë të licencuara me kriteret minimale kundrejt atyre që kanë ofruar më shumë se një menaxher të licencuar.

Në Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), pika 9.1, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nën-pika b) kërkohet: **Operatori duhet të ketë pasur të paktën 150 roje fizike për kryerjen e shërbimeve të ngjashme të sigurisë fizike gjatë 6 muajve të fundit.** Gjatë përcaktimit të kërkesave për kualifikim, Autoriteti Kontraktues duhet ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të operatorëve ekonomik të rinj dhe të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë të tillë që nuk përjashton operatorët ekonomik të rinj të cilët posedojnë në një shkallë të kënaqshme mundësitë ekonomike, financiare dhe/ose teknike

Në Kërkesën për inicim të aktivitetit të prokurimi (nr.35), fushëveprimi i aktivitetit të prokurimit konsiderohet Punë, ndërsa në procedurat e mëtutjeshme klasifikohet si Shërbim. Po ashtu në të njëjtën shkresë, thuhet se ky projekt nuk është shumë vjeçar. Në “Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve”, e datës 10/04/2013, Pika II.2 Disponueshmëria e Fondeve, nën-pika II.2.1 A është ky projekt shumë-vjeçar? Është nënvizuar me JO, ndërsa në: Në Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), pika 5.4 Kjo kontratë publike kornizë ka kohëzgjatje prej 36 muajsh dhe është efektive prej datës në të cilën ajo hyn në fuqi.

Konsiderojmë se veprimet e Autoritetit Kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi; nenin 27 Dosja e Tenderit; nenin 71 Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042, si dhe Neni 8 Kriteret e Përzgjedhjes i Rregullores për Prokurim Publik.

Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon që të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për shërbyesit ose shërbyesit potencial. Pra, të shmanget çdo trajtim që favorizon një shërbyes të caktuar ose shërbyes potencial.

Agjencia Kundër Korrupsion konsideron se praktika të tilla nuk duhet lejuar, andaj rekomandon anulimin e këtij aktiviteti, duke mos i përsëritur praktikat e ngjashme në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!